

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me seksionin 11, neni 3, shkronja f, seksionin 21.1 dhe seksionin 21.2. të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, seksionin 40, shkronja f, dhe 57, pragrafi 2 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e të dates 28.03.2002, miratoi

R R E G U L L A T

PËR PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE

Seksioni 1

Qëllimi i zbatimit

1.1 Vendimi i tanishëm Komunal do të rregulloj: (a) themelimin e tri (3) Komiteteve të mëposhtme mandatore:

- (i) Komiteti për Politikë dhe Financa; (i cili do ta caktoj me një vendim të veçantë Nënkomitetin për Personel dhe Punësim)
- (ii) Komiteti për Komunitete;
- (iii) Komiteti për Ndërmjësime

(b) Caktimi i nëntë (9) komiteteve të mëposhtme jomandatore:

- (i) Komiteti për Planifikim, Urbanizem, Burime Natyrore dhe Ambient;
- (ii) Komiteti për Ankesa, Peticione dhe Kontrollë të Përgjithshëm;
- (iii) Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenje Sociale dhe Strehim;
- (iv) Komiteti për Arsime dhe Shkencë;
- (v) Komiteti për Zhvillim Rural;
- (vi) Komiteti për Shërbime Publike;
- (vii) Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport;
- (viii) Komiteti për Pronësi;
- (ix) Komiteti për Gadishmëri Emergjente.

1.2 Vendimi i tanishëm Komunal do të vendosë për përbërjen e komiteteve të ndryshme, kompetencat dhe aktivitetet e tyre.

Seksioni 2

Seksioni i definimit

2.1 Komitetet

Komitetet janë pjesë të Kuvendit të Komunës dhe punojnë për dhe në emër të Kuvendit. Roli i tyre është që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve pasi që Kuvendi në tërsi nuk është në gjendje që në mënyrë adekuate të merret me numrin jashtëzakonisht të madh të problemeve dhe

detajeve. Shumë probleme me të cilat ballafaqohet komuna janë të një natyre teknike e që kërkojnë angazhimin e ekspertëve që nuk janë anëtarë të Kuvendit por shërbejnë si anëtarë të komiteteve relevante. Prandaj, komitetet janë të destinuara që ta lirojnë Kuvendin nga humbjet joproduktive të kohës dhe përpjekjeve, duke i ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit ekspertiza politike dhe teknike, konsultime dhe angazhim në çështjet specifike.

Themelimi i komiteteve jomandatore i përgjigjet nevojave të Komunës së Prishtinës të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës. Komitetet do të mbajnë mbledhje punuese sipas nevojës dhe minimumi është një mbledhje çdo muaj. Në mbledhjen e parë në secilin vit fiskal secili Komitet do të caktoj datat në të cilat do të mbahen mbledhjet e rregullta gjatë vitit. Mbledhje shtesë mund të thirren në çdo kohë.

2.2 Karakteristikat e përbashkëta

Shumica e komiteteve gjithmonë do të jenë anëtarë të Kuvendit Komunal. Anëtarësia e secilit komitet do të reflektohet sa më shumë që është e mundur me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin e Komunës, nëse kjo nuk është paraparë ndryshe me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45. Emrimi i anëtarëve të disa komiteteve do të përgjigjet specifikimit të tyre siq është rasti me disa komitete mandatore.

Seksioni 3

Komitetet – kompetencat e përgjithshme dhe rolet:

3.1. Komitetet do të bëjnë analizimin dhe formulimin i synimeve politike, kriterëve, strategjive dhe prioritetëve të buxhetit brenda një fushe të caktuar në mënyrë që të drejtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe të aprovohen nga Kuvendi i Komunës.

3.2. Komitetet do të jenë përgjegjës për paraqitjen e programit për shpënzime kapitale dhe vlerësimin e të hyrave dhe shpënzimeve në bazë të llogarive hyrëse për këtë periudhë(a), dhe në këtë formë e këtë datë(a) sipas kërkesave të Komitetit për Politikë dhe Financa.

3.3 Komitetet do të bëjnë analiza të rregullta të aktiviteteve të drejtorateve përkatëse (planet e punës, raportet mujore dhe vjetore, raportet mbi vlerësimin, etj.) dhe formulimin e propozimeve për kryeshefin e ekzekutivit dhe Kuvendin, në përmirësimin e kryerjes së punëve nga drejtoratet.

Komitetet do të sigurojnë monitorimin e ndërmarrjeve komunale të veqanta përmes bordeve mbikqyrëse, do të ofrojnë analiza mbi aktiviteteve të tyre, formulojnë propozime për kryeshefin e ekzekutivit dhe Kuvendin në përmirësimin e kryerjes së punëve nga ndërmarrjet.

3.4 Komitetet do të sigurojnë monitorimin dhe rregullimin i ekzekutimeve financiare në sferat përkatëse gjatë çdo viti fiskal.

3.5 Komitetet do të autorizojnë shpënzimet për projekte të posaqme në pajtueshmëri me ushëheqësit e programeve për shpënzime kapitale të miratuara nga Kuvendi.

- 3.6 Komitetet do të sigurojnë shqyrtimin dhe modifikimin e programeve kapitale të shpenzimeve duke shtuar, hequr apo modifikuar materialin e projektit të programit që do të aprovohet nga Komiteti për Politikë dhe Financa.
- 3.7 Komitetet do të sigurojnë përgatitjen dhe hartimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës që i referohen një fushe të caktuar të aktiviteteve brenda përgjegjësisë të komitetit.
- 3.8 Kompenzimi: Të gjithë anëtarët e komiteteve do të marrin kompenzim financiar për pjesëmarrje në punën e komiteteve komunale. Kryesuesi i komitetit do të jetë përgjegjës për koordinimin e punës së komitetit komunal, si dhe të përgatis orarin e mbledhjeve ad hocke, të udhëheqë listen e pjesëmarrësve, të siguroj procedurat e kompenzimit të anëtarëve të komitetit, informatat mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe të paraqes raport statusin për punën e komitetit.
- 3.10 Komitetet lejohen që të bashkëpunojnë me organet dhe autoritetet qendrore relevante.
- 3.11 Komitetet mund të formojnë nënkomisione dhe grupe punuese për detyra të caktuara brenda mandatit të tij.
- 3.12 Administrata komunale do të ofroj mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për rregullimin e punëve të komiteteve duke përfshirë, por jo edhe duke qënë e kufizuar në: shpërndarjen e materialeve për mbledhje sipas nevojës; vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen në dosje të procesverbaleve dhe materialeve të tjera të komiteteve.

Seksioni 4

Komitetet Mandatore:

Komiteti Për Politikë dhe Financa

Përbërja

Njëmbëdhjetë anëtarë të Kuvendit. Kryetarët e komitetve të Kuvendit gjithmonë ftohen të marrin pjesë si mysafirë/vrojtues. Kryetari i Kuvendit të Komunës do të jetë kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa. Së paku dy përfaqësues të minoriteteve duhet të jenë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kompetencat:

- 1) Të propozoj draft buxhetin
- 2) Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoratin për Ekonomi dhe Financa si dhe Drejtoratin për Administratë të Përgjithshme
- 3) Të identifikoj dhe të formuloj programet zhvillimore strategjike të Komunës
- 4) Të përcaktoj dhe zhvilloj format dhe mënyrat e organizimit të të hyrave në buxhet
- 5) Të zhvilloj procedurat investive dhe të shpenzimeve të buxhetit sipas vlerësimeve
- 6) Të ofroj kontroll të përgjithshëm ekonomik dhe financiar mbi ndërmarrjet komunale përmes bordeve mbikqyrëse

- 7) Ti shqyrtoj nevojat e medha ekonomike dhe sociale të Komunës si dhe çështjet më rendësi të veqantë
- 8) Mbështetja e zhvillimit ekonomik brenda Komunës duke përfshirë komercializimin dhe privatizimin
- 9) Të këshilloj Kuvendin në mënyrë të përgjithshme në lidhje me procedurat financiare dhe ekonomike
- 10) Të jetë përgjegjës për caktimin dhe kontrollimin e financave, pronës, fuqisë punëtore, dhe burimeve tjera të Kuvendit
- 11) Koordinimi i burimeve të Kuvendit të Komunës
- 12) Të ndihmoj në përgatitjet për emrimin e drejtorëve dhe të bëjë rekomandime në Kuvendit e Komunës
- 13) Të merret me çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e anëtarëve dhe meditet
- 14) Të mbikqyr aktivitetet e administratës komunale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun dhe ndërlidhjen me shtypin
- 15) Të mbeshtes partneritetet në mes të qyteteve
- 16) Të ushtroj të gjitha funksionet e Kuvendit të Komunës në raste emergjente të cilat përcaktohen nga kryetari i Komunës
- 17) Të merret me funksionet autorizuese dhe detyrat e Kuvendit të Komunës
- 18) Shlyrjen e borgjeve të dëmshme
- 19) Komiteti do të paraqes një raport në çdo mledhje të Kuvendit të Komunës që do të tregoj gjendjen financiare të Komunës
- 20) Për çdo vit fiskal, numri i stafit që to të emërohet apo mbetet në secilin drejtorat së bashku me titujt dhe gradat e tyre do të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

4.2 Nënkomiteti për Përsonel dhe Punësim

Përbërja

Anëtarë të Kuvendit (së paku një femër dhe se paku një përfaqësues i Komuniteteve të Pakicave) – të deleguar nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Kompetencat

- 1) Nënkomiteti do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me nenin 75, paragrafi 6 i Statutit dhe Rregullave të Procedurave të Komunës së Prishtinës, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 si dhe ndonjë ligj tjetër relevant dhe i aplikueshëm.

Nënkomiteti për Përsonel dhe Punësim do të këshilloj dhe konsulloj në mënyrë të përgjithshme për çështjet e burimeve njerëzore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil Komunal e në veqanti për çështjet e më poshtme:

- (a) Kategoritë dhe numrat për kategori;
- (b) Mbikqyrja dhe përgjegjësia;
- (c) Detyrat dhe përgjegjësitë;
- (d) Delegimi i detyrave dhe përgjegjësive;
- (e) Rekrutimi dhe selektimi;
- (f) Pranimi i kushteve;

- (g) Marrja e detyrës, emërimi zyrtar dhe kushtet e punësimit;
- (h) Procedurat disiplinare dhe të largimit;
- (i) Procedurat për ankesa;
- (j) Procedurat për lutje;
- (k) Trajnimi dhe kontrollimi;
- (l) Shqyrtimi i kryerjes së detyrave dhe procedurat e vlerësimit;
- (m) Progresi në profesion dhe gradimi;
- (n) Shënimet e stafit dhe referencat;
- (o) Përiudha e emërimit dhe vërejtja për largim nga puna;
- (p) Pagesa dhe shpërblimet tjera;
- (q) Pagesat për udhëtim dhe mjete jetese;
- (r) Pushimi;
- (s) Rregullat mbi Shërbimin Civil Komunal;

Në strukturën e Komunës, Shërbimi Civil Komunal është organizuar në mënyrë që të koordinoj shërbimet, të kryej detyrat dhe plotësoj nevojat direkte të popullatës.

4.3 Komiteti për Komunitete

Përbërja

12 Anëtarë, në mënyrë specifike:

1 Rom, që është përfaqësues i komunitetit por jo anëtarë i Kuvendit të Komunës.

1 Turk, që është përfaqësues i komunitetit por jo anëtarë i Kuvendit të Komunës.

1 Ashkali, që është përfaqësues i komunitetit por jo anëtarë i Kuvendit të Komunës.

1 Boshnjak, që është përfaqësues i komunitetit por jo anëtarë i Kuvendit të Komunës.

5 Serb, së paku njëri nga ta duhet të jetë përfaqësues i komunitetit por jo anëtarë i Kuvendit të Komunës. Së paku një anëtarë i Komitetit për Komunitete duhet të jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

3 Shqiptarë, së paku njëri nga ta duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Administratori i Komunës do të emëroj anëtarët e Komitetit për Komunitete të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

2. Kompetencat

a) Në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45, Komiteti për Komunitete do të përpiqet që brenda territorit të komunës të siguroj se:

- Anjë person që kryen detyra zyrtare apo punon në zyre publike nuk do të diskriminoj ndonjë person tjetër në çfarëdo baze siq është gjuha, religjioni, origjina etnike, apo asocijimi me ndonjë komunitet.
- Të gjithë personat i gëzojnë në masë të njëjtë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe një punësim i drejtë dhe i barabartë duhet të shërbej në komunë në të gjitha nivelet.

- Shërbimi civil komunal reflekton një proporcion të drejtë të përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

b) Komiteti për Komunitete do të siguroj të drejtat dhe intereset e të gjitha komuniteteve që jetojnë brenda komunës, dhe gjithashtu të sigurohet se një shoqëri ku shumëllojshmëria e traditave kulturore, sociale dhe religjioze është jo vetëm e toleruar por edhe e inkurajuar.

c) Në qoftë se Komiteti për Komunitete konsideron se një veprim është ndërmarrë, apo është propozuar të ndërmerret nga apo në emër të Kuvendit të Komunës, i cili i ka cenuar të drejtat e komunitetit apo të një anëtari të komunitetit apo i cili është apo mund të jetë i dëmshëm për interesat e një komuniteti, ai do ti referoj çështjen menjëherë Komitetit për Ndërmjetësim. Më qëllim të ndonjë votimi për çështje të caktuara, vota vendimtare do të konsiderohet të jetë në mbështetje të çështjes së caktuar.

d) Në qoftë se Kuvendi i Komunës nuk arrin që të merr vendim në pajtueshmëri me Seksionin 23.8, brenda 21 ditësh nga dita e paraqitjes së raportit nga Komiteti për Ndërmjetësim apo Komiteti për Komunitete nuk është i kënaqur me vendimin e marrë nga Kuvendi i Komunës, mund t'ua referoj çështjen autoriteteve qendrore për rishqyrtim.

e) E drejta e Komitetit për Komunitet që t'ia referoj një vendim autoriteteve qendrore do të shqyrtohet në pajtueshmëri me procedurat që do të themelohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

f) Komiteti do ti mbikqyr aktivitetet e Zyrës për Komunitete dhe nënzyreve të saja dhe të formuloj propozime për kryeshefin e ekzekutivit dhe Kuvendin e Komunës për përmirësimin e punëve të Zyrës.

4.4 Komiteti për Ndërmjetësim

Përbërja

8 Anëtarë – në mënyrë specifike:

4 anëtarë të Kuvendit të Komunës (3 Shqiptarë dhe 1 Serb), të cilët nuk janë anëtarë të Komitetit për Komunitete dhe,

4 përfaqësues të komuniteteve (1 Serb, 1 Rom, 1 Ashkali dhe 1 Turk), të cilët nuk janë as anëtarë të Kuvendit të Komunës e as të Komitetit për Komunitete.

Administratori i Komunës do ti emroj anëtarët e Komitetit për Ndërmjetësim të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Kompetencat

- 1) Të shqyrtoj vetëm ato çështje që i referohen nga Komiteti për Komunitete.
- 2) Do të kryej hulumtime sipas nevojës në mënyrë që të dëshmoj nëse të drejtat e një komuniteti apo një anëtari të ndonjë komuniteti janë cenuar ose do të cenoheshin, apo veprimi i cili është apo mund të jetë i dëmshëm për interesat e një komuniteti

është ndërmarrë apo propozuar. Do të kërkoj që ta zgjedh çështjen përmes ndërmjetësimit. Komiteti për Ndërmjetësim, brenda 28 ditësh nga dita e referimit nga Komiteti për Komunitete, paraqet një raport në Kuvendin e Komunës për secilën çështje, me rekomandimet se si të shqyrtohet çështja në fjalë.

- 3) Kuvendi i Komunës do të shqyrtoj çdo raport që i është paraqitur nga Komiteti për Ndërmjetësim dhe do të vendosë se çfarë veprimesh të mëtutjeshme do të ndërmerren në lidhje me atë çështje.

Seksioni 5

Komitetet jomandatore

5.1 Komiteti për Planifikim Urban, Burime natyrore dhe Ambient

Përbërja

Përbëhet nga 11 anëtarë prej të cilëve së paku 6 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit; së paku 2 prej tyre të jenë përfaqësues të pakicave dhe së paku 2 femra.

Kompetencat

a. Planifikimi

1. Të këshilloj dhe kosullohet me Drejtoratin për Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimit
2. Komiteti është i përfaqësuar, më së paku një anëtarë, në Bordin Mbikqyrës të Drejtoratit për Tokë Ndërtimore dhe Ndërmarrjen Komunale “Hortikultura” dhe “Trafikun Urban”
3. Të monitoroj zhvillimin e Planit të ri Urbanistik
4. Shqyrtimi i çështjeve në lidhje me transportin publik dhe propozimet strategjike për magjistrale
5. Shqyrtimi i nevojës, dizajnit dhe lokacionit për të gjitha zhvillimet e reja
6. Të monitoroj çdo çështje që ka të bëjë me ndërtimin
7. Përgaditja e prioriteteve dhe implementimi i mëpastajmë
8. Shqyrtimi dhe përcaktimi sipas mënyrës së lejitimit apo refuzimit të kërkesave për lejitimin e planifikimit për ndërtim, injinjering, mihje apo punë ndërtimore
9. Të kontrolloj procedurat për vendosjen/lisencimin e kioskeve
10. Të kontrolloj procedurat për reklamimet (panot)
11. Të kontrolloj procedurat për zbatimin e planifikimit, vërejtjet për ndalim dhe urdhërat për rrënim,
12. Të ushtroj mbrojtjen dhe kontrollimin e ndërtesave me interes arkitektonik apo historik,
13. Përgjegjës për rregullimin dhe kontrollimin e ndërtesave.

b. Burimet Natyrore

1. Të shqyrtoj draft procedurat dhe rregulloret për zhfrytëzimin e burimeve natyrore, bëjë komente dhe korigjime në të njëjtat dhe t'i dorëzoj Kuvendit të Komunës si draft urdhër komunal
2. Të shqyrtoj kërkesat që momentalisht i janë dorëzuar Kuvendit të Komunës dhe të shqyrtoj se çfarë veprimi duhet të merret në këtë drejtim
3. Të jetë pjesëmarrës në departamentet dhe agjencionet qeveritare të caktuara për nxjerrjen e rregulloreve
4. Monitorimi i shfrytëzimit të rezervave të ujit dhe ujit nëntokësor, dhe shfrytëzimi i tokës apo terenit me ndikim për burimet e ujrave nëntokësore.

c. Ambienti

1. Të ndihmoj dhe të ruaj ambientin,
2. Të paraqes masat në kontrollimin zhurmës,
3. Parandalimi i ndotjes ambientale të ajrit, tokës dhe ujit,
4. Monitorimi dhe lajthitja e parqeve, fushave rekreative dhe të argëtimit, shëtitoreve publike, hapësirave të hapura publike të Komunës

5.2 Komiteti për Ankesa, Peticione dhe Kontroll të Përgjithshëm

Përbëria

Përbëhet nga 5 anëtarë të Kuvendit (së paku 1 femër dhe 1 përfaqësues nga komuniteti i pakicave).

Kompetencat

1. Komiteti merret me ankesat dhe peticionet të cilat i janë drejtuar Komunës (kryetarit apo nënkryetarit të Kuvendit komunal, kryeshefit, departamenteve, zyreve dhe zyrtarëve komunal, vetë komitetit, administratorit komunal, etj.) në pajtim me seksionin³³ të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45
2. Komiteti ka të drejtë të ketë dhe të paiset përmes kryeshefit ekzekutiv dhe/ose përmes drejtorëve të drejtorateve me të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara
3. Komiteti i kryen detyrat e tij përmes kryeshefit ekzekutiv dhe/ose përmes drejtorve të drejtorateve
4. Komiteti mund t'i sugjeroj Kuvendit të Komunës ose kryeshefit ekzekutiv nëpërmes kryetarit të Kuvendit të Komunës që të ndërrmerren masa.
5. Në bazë të vendimit të vet ose në bazë të vendimit të marrë nga Kuvendi i Komunës, komiteti, gjithashtu mund të kontrolloj punën e kryer nga administrata komunale
6. Komiteti mund të jap rekomandime procedurale për vendimet, ndërmjetsimet apo procedurat e mëtejshme për kërkesa, ankesa dhe peticione për cilatdo oragane dhe zyrtarë komunal.

5.3 Komiteti për Shëndetësi, Strehim, dhe Mirëqenie Sociale

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 10 anëtarë, së paku 6 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 2 prej tyre të jenë përfaqësues nga pakicat dhe duhet të jenë së paku 3 femra.

Sipas nevojës personat në vijim gjithashtu do të marrin pjesë :

- Administratori i Komunës,
- Drejtori i Urbanizmit dhe Ndërtimit,
- Drejtori i Qendrës për Punë Sociale,
- Shoqata “Nëna Terezë”,
- UNHCR
- Koordinator i Regjional për Rindërtimin e Shtëpive,
- Zyrtarët udhëheqës komunal për punë sociale dhe shëndetësore (psh. drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, udhëheqësit e nën-zyreve të drejtoratit, drejtori i Shtëpisë së Shëndetit dhe drejtori i Qendrës për Punë Sociale) mund të jenë të ftuar të marrin pjesë në mbledhje dhe do të kenë të drejtë të shtrojnë pika në rend të ditës por pa të drejtë vote.

Dispozitat:

Puna e komitetit do të jetë konfidenciale në rastet private të qytetarëve dhe informatat që kanë të bëjnë me personat privat.

Kompetencat

a. Strehimi

1. Të shqyrtoj, këshilloj dhe konsultohet me Drejtoratin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komiteti përfaqësohet në Bordin mbikqyrës të Ndërmarrjes Komunale Banesore,
3. Të ndihmoj në caktimin e fondeve në pajtim me Ministrinë e Punës për Strehim dhe Rindërtim të Kosovës
4. Të ushtroj kompetencat dhe detyrat e Komunës në lidhje me strehimin,
5. Formulimi i propozimeve për strategjitë strehuese duke përfshirë ndërtimin e shtëpive me qira, dhe prioritetet kryesore përkatëse për renovime ndërtimesh dhe ndihmë financiare,
6. Kthimi i menagjimit për riparimin dhe përmirsimin e të gjitha ndërtesave që mbahen nga Komuna për qëllime strehuese,
7. Aprovimi i kredive dhe huave për përmirsimin apo riparimin e shtëpive,
8. Dispozitat e strehimit për të pastrehët,
9. Në bashkëpunim me UNHCR tu ofrohet strehim refugjatëve, të elaborohen planet dhe të bëhet një zgjidhje emergjente për fluksin e tyre, rikthimin e tyre në vendet e tyre, të zhvendosurit dhe personat me bregat të tjera humanitare,
10. Zbatimi i standardeve për përmirsimin e përshtatshëm dhe riparimin e strehimoreve private,
11. Kontrollimi i ndërtimit të shtëpive,

12. Shqyrtimi i hollshëm i propozimeve për plane strehuese,
13. Caktimi i kontratave të qerasë për pronë komunale,

b. Shëndetësia

1. Të monitoroj implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetsor në Komunë,
2. Komiteti përfaqshohet në Bordin mbikqyrës të Shtëpisë Komunale të Shëndetit dhe Shërbimit të Urgjencës,
3. Paraprakisht miraton buxhetin për Sektor dhe i dorëzon atë Kuvendit,
4. Kshillon dhe konsullton në lidhje me punësimin dhe shkarkimin e punëtorëve të vjetër komunal shëndetsor në pajtim me Drejtoratin komunal të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale si dhe merret me procedurat ekzistues për këtë çështje. Është pjesë e procesit të rekrutimit, modifikon dhe rishikon rasted sipas nevojës
5. Rishqyrton dhe modifikon sipas nevojës planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale,
6. Rishqyrton dhe modifikon raportin vjetor të përgaditur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,

c. Mirëqenja Sociale

1. Dispozitat e mbështetjes komunale për grupet e varfëra të njerëzve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët, të miturit, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët, etj)
2. Përgjegjës për Qendrën për Punë Sociale dhe shpërndarjen e skemës për ndihmë sociale në pajtim me rregulloret dhe direktivat e autoritetit qëndror.

5.4 Komiteti për Arsim dhe Shkencë

Përbërja

8 anëtarë prej të cilëve së paku 5 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 2 prej tyre duhet të jenë përfaqshues të pakicave; së paku 3 femra.

Kompetencat

1. Të shqyrtoj rregullat komunale vendore të aplikuara të rregulloreve për arsim,
2. Të këshilloj dhe konsulltohet me Drejtoratin e Arsimit dhe Shkencës përmes kryeshefit ekzekutiv
3. Të përgatis vijëveprimet dhe udhëzimet e arsimit për t'ju dorëzuar Kuvendit të Komunës për miratim
4. Të dëgjoj apelet nga stafi kundër masave disiplinore
5. Të dëgjoj apelet nga studentët (nxënësit) në lidhje me kualitetin e mësimin dhe masat disiplinore
6. Të themeloj dhe mbështes raportin shkollë-shoqëri në mes të shkollave dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që cilat merren me arsimimin e personave

7. Të parashikoj dhe vlerësoj nevojat arsimore të shoqërisë në të ardhmen
8. Të hartoj propozime dhe të inicioj planet lokale arsimore, prioritetet, programet dhe projektet për autoritet qendrore dhe drejtoratet tjera komunale
9. Të mbështesë raportin shkollë-prindër në mes të shkollave, prindërve dhe familjeve.

5.5 Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport

Përbërja

Përbëhet nga 8 anëtarë, së paku 5 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 2 prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave; së paku 3 femra

Kompetencat

1. Të përcaktoj prioritetet globale për qytetin në sferat e Kulturës, Sportit dhe Rinisë,
2. Të hartoj një program të investimeve kapitale në mënyrë që tu ofroj institucioneve kushtet e nevojshme,
3. Të ofroj një pasqyrë buxhetore dhe të bëjë rekomandimet e nevojshme,
4. Të mbështesë Drejtoratin në mënyrë që tu jap këtyre sektorëve vendin e merituar në bazë të prioritetëve për Komunën,
5. Të këshilloj dhe konsulltohet me Drejtoratin për Kulturë, Sport dhe Rini përmes kryeshefit të ekzekutivit,
6. Të këshilloj dhe konsulltohet me institucionet kryesore dhe ndërmarrjet komunale përmes bordeve mbikqyrëse (si Sport Marketingu, Qendra e Rinisë dhe Sporteve),
7. Të ndërmjetsoj në federatat dhe asociacionet si dhe me organet vullnetare të angazhuara në kulturë, rini dhe sport
8. Ti kushtoj vemendje të veçantë nevojave të lagjeve periferike dhe rajoneve rurale,
9. Të mbështesë kremtimin e festave të njohura ndërkombëtarisht (Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, e Muzikës etj.),
10. Të paraqes dhe rekomandoj për diskutimet buxhetore, ngjarjet e rregullta dhe të rëndësishme: festivalet, kampionatet etj.
11. Të mbështesë ndryshimet ndërkombëtare
12. Ti kushtoj kujdes të veçantë ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit.

5.6 Komiteti për Pronësi

Përbërja

Përbëhet nga 7 anëtarë prej të cilëve së paku 4 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 1 prej tyre duhet të jetë përfaqësues i pakicave.

Kompetencat

1. Të mbështes zhvillimin e ardhshëm të Komunës, posaqërisht në lidhje me vijë-veprimin e tokës,
2. Të shqyrtoj rekomandimet nga drejtori i Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës në çështjet lidhur me përvetësimin dhe dhënjen e tokës dhe ndërtesave që i takojnë Komunës,
3. Të këshilloj dhe konsullohet me Drejtoratin e Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës përmes kryeshefit ekzekutiv,
4. Në varësi nga mjetet financiare të caktuara për blerje, shitje ose dhënie të tokës ose ndërtesës me qira, të jap efekt në zhvillimin e Komunës dhe për këtë qëllim të diskutoj kushtet për përvetësimin e tokës ose lidhjen e kontratave dhe plan projekteve të përbashkëta për blerje apo shitje dhe të autorizoj ekzekutimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme juridike. Komiteti duhet të përcakton mënyrën e dhënjes dhe metodën ku kushtet duhet të diskutohen.
5. Përbrenda vijë-veprimeve të vendosura dhe vlerësimeve të aprovuara të Kuvendit, t'i rekomandohet Kuvendit përvetësimin apo dhënien qoftë nëpërmes blerjes, shitjes, lëshimit me qira, liçencimit apo dhurimit të tokës apo objektit ose në interesat e të drejtat në lidhje me token.

Cështjet e deleguara Nënpunësve

a. Drejtorit të Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronësisë

Të hap dhe pranoj tenderet kur metoda e dhënies është aprovuar paraprakisht nga Komiteti.

5.7 Komiteti për Zhvillimin e Zonave Rurale dhe Bujqësi

Përbërja

Përbëhet nga 9 anëtarë, së paku 5 prej të cilëve duhet të jenë anëtarë të Kuvendit; së paku 1 prej tyre duhet të jetë përfaqësues i pakicave.

Kompetencat

1. Të këshilloj dhe konsullohet me Drejtoratin për Zhvillim Rural përmes kryeshefit ekzekutiv
2. Inicimi i programeve dhe projekteve zhvillimore për zonat rurale,
3. Të siguroj mbrojtjen dhe zhvillimin i pyllit
4. Të siguroj zhvillimi bujqësor
5. Të siguroj zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe të infrastrukturës në zonat rurale
6. Të mbështes rindërtimin e fshatërave
7. Të zhvilloj programet për arsimim.

5.8 Komiteti për Shërbime Publike

Përbërja

Përbëhet nga 10 anëtarë, së paku 6 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit; së paku 2 prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave.

Kompetencat

1. Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoratin për Shërbimeve Publike dhe Transport
2. Të shqyrtoj planin e punës së Drejtoratit
3. Diskuton, ndryshon dhe aprovon projektregulloret e Komunës të përgaditura nga drejtori dhe i dorëzon Kuvendit të Komunës për miratimn përfundimtar
4. Monitoron zhvillimin dhe implementimin e planeve dhe vijëveprimeve në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe veprimeve
5. Komiteti është i përfaqësuar në bordet mbikqyrëse të "Higjiena – Teknikës", "Termokosit", "Tregut", "Batllavës"
6. Përmes bordeve mbikqyrëse të ndërmarrjeve komunale: themelon vijëveprime, përshtat nivelet e shërbimeve dhe stafit, monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve; cakton burimet në përputhje me rrethanat
7. Aprovon dizajnin dhe ndërtimin e shërbimeve për ngrohje, mbeturina, ujë dhe projekteve për menagjimin e ujrave të zeza në bashkëpunim me ndonjë organ kompetent sipas Rregullorës së UNMIK-ut
8. Pranon buxhetin e propozuar vjetor për shërbime: miraton parashikimin e fondeve të nevojshme për kuadër, paisje, materiale dhe furnizim; implementon përshtatjen e buxhetit ashtu siq është e nevojshme dhe e domosdoshme.
9. Përgatitë raporte për Kuvendin e Komunës në sistemet operative dhe përmirsimet
10. Këshillon dhe konsultohet në lidhje me çështjen e mbledhjes së kuotave në inkasim në të gjitha ndërmarrjet shërbyese.

5.9 Komiteti për Gadishmëri Emergjente

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 8 anëtar, ku së paku 5 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, njëri prej tyre do të jetë përfaqësues i komuniteteve, njëri nga radhët e KFOR-it, një nga Policia si dhe një nga Drejtorati e Sigurisë Civile dhe Emergjencës.

Kompetencat

1. Të këshilloj dhe të konsultohet me drejtorin e Drejtoratit të Sigurisë Civile dhe Emergjencës.
2. Të shqyrtoj planin e punës të drejtorisë së Sigurisë Civile dhe Emergjencës.
3. Të propozoj masat adekuatedhe të angazhoj institucionet përkatëse për ndihmë popullsisë së rrezikuar me qëllim të zbutjes së dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit elementare tjera të mëdha.
4. Të marr masa adekuate për angazhimin e potencialit njerzor dhe mjetave materiale në zvoglimin dhe eliminimin sa më të mundshëm të pasojave të shkaktuara nga këto

- fatkeqësi duke vepruar konkretisht në vendin e ngjarjes.
5. Të propozoj masa konkrete për funksionimin e qendrës për koordinim, informim dhe alarmim.
 6. Të ushtroj kontrollimin e ndërmarrjeve me interes të veçantë për Komunën në paisjen dhe mënyrën e mbrojtjes kundër zjarrit, kjo vlenë edhe për të gjitha bashkësitë lokale në Komunë.
 7. Të koordinoj punët me njësitin e zjarrëfikësve për reagim sa më të shpejt në rast të paraqitjes së nevojës.
 8. Të koordinoj punët me SHPK-n, TMK-n, Policin e UNMIK-ut , KFOR-in, Qendrën emergjente të shëndetësis familjare, Kryqin e Kuq Komunal për një organizim më efikas në zbutjen e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësit e ndryshme.

Seksioni 6

Hyrja në fuqi

6.1 Këto Rregulla hyjnë në fuqi nga data e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
_____**Nr.**_____ **Dt.**_____

KRYETARI I KUVENDIT
Dr. Salih Gashi